



**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS**  
**FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA**  
**FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO**

**Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i shkallës së parë** në përbërje prej: Metë Çeku – kryetar, Avni Shala dhe Donat Lushaku – anëtarë, duke u mbështetur në nenin 63, paragrafi 1, dhe paragrafi 4, të Statutit të FFK-së, si dhe nenit 8, paragrafi 4, pika e), neni 53, paragrafi 1, pika c), të Rregullorës Disiplinore, neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3., pika b) e Kodit të Etikës së FFK-së dhe neni 52 paragrafi 1, pika h), dhe neni 53, të Propozicioneve të Garave 2023/2024, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2024, shqyrtoi procedurën e hapur disiplinore ndaj FC Drita nga Gjilani për lëshim në organizimin e ndeshjes gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll ndërmjet FC Drita dhe FC Prishtina, e zhvilluar me datë 24.04.2024 në Stadiumin me bari sintetik në Gjilan, merr këtë:

**V E N D I M**

**I.** Klubit FC Drita nga Gjilani i shqiptohet masa disiplinore “*zhvillimi i katër (4) ndeshjeve në terren të vetë pa praninë e shikuesve*” i cili është i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së këtij vendimi.

**II.** Klubit FC Drita nga Gjilani i shqiptohet “*Dënimin me gjobë në lartësi prej 1,500.00 € (njëmijë e pesëqind euro)*”, i cili duhet të paguhet në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Vendimi.

**A r s y e t i m**

Me datë 24.04.2024 me fillim nga ora 13:00 është zhvilluar ndeshja e gjysmëfinale së Kupës së Kosovës në futboll në kategorinë e seniorëve në mes të ekipeve FC Drita nga Gjilani dhe FC Prishtina nga Prishtina. Pas përfundimit të kësaj ndeshje, tifozët e klubit FC Drita manifestuan sjellje të ashpra, josportive e të cilat dëmtojnë autoritetin sportiv të futbollit. Sjelljet e tyre duke u manifestuar me gjuajtje të gjësendeve të palejuara në drejtim të lojtarëve të klubit FC Prishtina, për afërsisht rreth njëzetë e pesë (25) shishe PVC, ashtu që tifozët e FC Dritës kalojnë rrethojat, duke depërtuar në fushë dhe konfrontuar drejtpërsëdrejti fizikisht me zyrtarët e klubit FC Drita.

Meqenëse klubi FC Drita ka dështuar që mbarëvajtja e ndeshjes të jetë në konfirmimet me dispozitat e akteve normative të FFK-së, të njëjtit kanë dështuar që të veprojnë konform neni 53, pika c) të Rregullores Disiplinore ku parashihet se “*Klubi organizator i ndeshjes në terrenin e të cilit para ndeshjes, gjatë dhe pas ndeshjes, lidhur me ndeshjen, ndodhin trazira dhe nëse vërtetohet se nuk ka ndërrmarrë masa të mjaftueshme, si dhe klubi mysafir simpatizuesit e të cilit shkaktojnë apo marrin pjesë në trazira, do të dënohet*”. Tutje në të njëjtin nen janë të listuara masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen në varësi nga shkelja e bërë nga ana e klubit. Pra, në pikën c të këtij neni parashihet si masë disiplinore “*në raste të tentimit të sulmit të publikut ndaj personave zyrtar apo futbollistëve të të dy ekipeve – mund të dënohet me moszhvillimin e; 2 (dy) deri në 4 (katër) ndeshjeve në fushën e vetë pa praninë e shikuesve, dënim me të holla*”.



**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS**  
**FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA**  
**FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVO**

Duke i'u referuar raporteve të zyrtarëve të ndeshjes si dhe incizimit të emisionit sportiv si provë materiale, Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i FFK-së, si organ i shkallës së parë ka vendosur që ndaj klubit FC Drita të ndërmarrë masa disiplinore sikurse në dispozitiv të këtij vendimi pasi sjelljet e tilla janë të papranueshme dhe në kundërshtim me aktet normative të FFK-së, dhe si të tilla duhen ndëshkuar.

Në nenin 8, paragrafi 4, pika e), të Rregullores Disiplinore të FFK-së parashihet masa disiplinore “*zhvillimi i ndeshjeve në terren të vetë pa praninë e shikuesve*”. Ndërkaq në nenin 53, pikën c) të Rregullores Disiplinore parashihet e drejta e Komisionit që krahas masës disiplinore përkatëse të kombinohet dhe me *dënimin me të holla* sikurse është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

Sjelljet e tilla janë të papërshtatshme, të papranueshme dhe jo sportive, kjo mund të shkaktojë dëme për imazhin dhe integritetin e sportit në përgjithësi. Ky vendim është i nevojshëm për të mbrojtur integritetin dhe imazhin e sportit dhe për të zbatuar rregullat dhe normat e përgjithshme të sjelljes sportive konform akteve normative të FFK-së.

Andaj bazuar në këto gjendjen faktike të lartcekura, Komisioni Disiplinor dhe i Etikës vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

**Prishtinë, 30.04.2024**

Komisioni- Disiplinor dhe i Etikës – shkalla e parë

Kryetar: Metë Çeku

**Këshilla juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh, nga data e publikimit të vendimit në web faqen zyrtare të FFK-së, përmes këtij Komisioni, tek Komisioni i Ankesave. *Ankesa e ushtruar ndaj këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.*